



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 20153 prot.

Vlorë, më 13.12 2024

PROJEKT-VENDIM
Nr. _____, Datë _____.2024

**“PËR PAGESËN E DETYRIMEVE DOGANORE DHE DETYRIMEVE TË TJERA
FINANCIARE, PËR MAKINERITË DHE PAJISJET E DESTINUARA PËR
BASHKINË VLORE DHE FONDI I PAKUSHTËZUAR VËNË NË DISPOZICION
PËR KËTË QËLLIM NGA MINISTRIA E FINACAVE”**

Në bazë të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8/1, neni 9/1, neni 54/m, Ligji nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Menaxhimit të Buxhetit”, Udhëzimi plotësues nr.2 datë 28.02.2024 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2024”, V.K.B nr.100 datë 29.12.2023 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2024” e ndryshuar, si edhe në shkresën nr.15135/1 prot, dt. 11.11.2024 të MF.

VENDOSI:

1. Të miratojë Grantin e pakushtëzuar të dhënë nga Ministria e Financave për shpenzimet e Landfillit Sherishtë:

• **Të ardhura gjithsej në lekë:** **37.000.000**
a. Fonde nga transfertat e pakushtëzuar 37.000.000

a. Të miratojë shpenzimet si më poshtë në lekë :

• **Shpenzime gjithsej në lekë** **37.000.000**
a. Për detyrime doganore (art.602) 26.400.000
b. Për detyrime transport, parkim etj (art.602) 10.600.000

b. Shpenzimet e pikës “a” do të përdoren sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Nr	Programi	Emërtimi	Shpenzimet e planifikuara nga fondet e ardhura	
			602	Totali
1	K01110	adm.Bashkia	37.000.000	37.000.000

2. Shuma prej 37.000.000 lekë, do të përdoret për pagesat e detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera financiare, për makineritë dhe pajisjet e destinuara për bashkinë Vlorë sipas kontratës me objekt “ Punime, projektim-furnizim dhe instalim impianti/ furnizim paisje për përpunimin e mbeturinave në Shërishtë Vlorë”, për zerat si më poshtë:

- Detyrimet Doganore për vlerën 11.400.000 lekë
- Detyrimet ndaj subjektit ELKOPLAST POLAND SPOLKA Z O.O për vlerën 5.000.000 lekë
- Detyrime Doganore për subjektin CONTINENTAL GROUP për vlerën 15.000.000 lekë
- Detyrime të tjera të parashikuara si Fond Rezerv në vlerën 5.600.000 lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015“Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55, pika 6

Ky Projekt - Vendim hyn në fuqi menjëherë!

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
NDËRMARRJA PUBLIKE BASHKIAKE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE

Nr. 282 prot.

Vlorë, më 12 . 12 .2024

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

**“PËR PAGESËN E DETYRIMEVE DOGANORE DHE DETYRIMEVE TE TJERA
FINANCIARE, PËR MAKINERITË DHE PAJISJET E DESTINUARA PËR BASHKINË
VLORË NGA FONDI I PAKUSHTËZUAR VËNË NË DISPOZICION PËR KËTË QËLLIM
NGA MINISTRIA E FINANCAVE”**

Të nderuar Këshilltarë !

Bashkia Vlorë ne rolin e Perfituesit , KFW në rolin e financuesit të projektit dhe shoqëria JV Bulfaro SPA & Integrated Technology Service shpk, në datën 27.04.2020 ka lidhur Kontrate me objekt “ *Punime, projektim - furnizim dhe instalim impianti / furnizim paisje për përpunimin e mbeturinave në Sherishtë Vlorë*” nëpërmjet të cilës, shoqëria JV Bulfaro SPA & ITS shpk merrte përsipër projektimin, punimet , furnizimet dhe instalimet e Impiantit për Ndërtimin e Qendrës Rajonale të Trajtimit dhe Depozitimit të Mbetjeve Urbane në Sherishtë, Vlorë, Qarku Vlorë

Shoqëria ITS shpk me NIPT L02302032C, është sekuestruar me Vendimin nr. 484 datë 13.12.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, duke qenë se ITS shpk, ishte person juridik i marrë në përgjegjësi penale për konsumin e veprave të ndryshme penale në gjatë aktivitetit të tij dhe që nuk kanë lidhje me Kontratën e sipërpërmendur.

Pas sekuestrimit shoqëria ITS shpk ka filluar të administrohet nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (APPSK) Për shkak të mosrealizimit në kohë të punimeve si dhe për arsye të dështimit të rinovimit të garancisë së performancës nga Shoqëria, më

datë 22.11.2023 Bashkia Vlorë pas njoftimeve zyrtare të dërguara nga Konsulentet Gjermane të projektit, ka njoftuar zgjidhjen e njëanëshme të Kontratës , për shkaqe që nuk kanë lidhje me punëdhënësin.

Një nga kushtet e kontratës ka qenë dhe furnizimi me makineri dhe pajisje. KFW në rolin e Financuesit të Projektit, në periudhën kur Kontrata ishte në fuqi, ka kryer të gjithë pagesat për furnizimin e makinerive dhe pajisjeve për impiantin.

Këto furnizime nuk kanë arritur t'i dorëzohen Bashkisë Vlorë dhe janë të bllokuara në doganë për shkak të mungesës së likuiditetit të shoqërisë ITS për shlyerjen e detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera financiare lidhur me to.

Pasi Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara mori në administrim shoqerine ITS shpk, në mënyrë të përsëritur, Bashkia Vlorë i është drejtuar asaj, për pagesën e detyrimeve të sipërpërmendura, gjë që do të mundësonte marrjen në dorëzim të pajisjeve dhe makinerive nga ana e Bashkisë Vlorë dhe do t'i hapte rrugë vënies në funksionim të Landfillit të Sherishtës.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara me shkresën nr. 4313/1 prot. datë 06.09.2024 është shprehur se nuk mund të përballonte shpenzimet dhe kostot që shoqëria Integrated Technology Service shpk kishte ndaj autoriteteve doganore për pajisjet dhe makineritë e sjella nga nënkontraktorët e huaj.

Në këto kushte , Bashkia Vlorë , në mungesë të mundësive financiare nga ana e saj, ka paraqitur pranë Ministrisë e Financave kërkesën për financimin nga fondi rezervë për njësitë e vetëqeverisjes vendore, të vlerës prej 37.000.000 lekë për shlyerjen e këtyre detyrimeve. Me shkresën nr.15135/1 datë 11.11.2024 Ministria e Financave konfirmoi financimin e vlerës së kërkuar.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me Vendimin Nr. 43 datë 08.11.2024 ka lënë në fuqi Vendimin Nr. 61 datë 05.10.2023 të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në cilin është vendosur konfiskimi dhe kalimi në favor të shtetit të pasurive të Integrated Technology Service shpk (ITS shpk) sekuestruar më parë me vendimin nr. 484 datë 13.12.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Kjo ka krijuar mundësinë që Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimin të Organizuar në Vendimin nr. datë 11.12.2024 *“Për kalimin në pronësi pa pagesë Bashkisë Vlorë të pasurive të luajtëshme të llojit makineri dhe pajisje në pronësi të shoqërisë Integrated Technology Service shpk”* t'i kalojë në pronësi pa pagesë Bashkisë Vlorë makineritë dhe pajisjet sipas tabelës së mëposhtme :

Nr.	Mjetet ose pajisjet	Vendndodhja	Sasia
1	Kontenier 35 m ³	Doganë	5
2	Kontenier 20 m ³	Doganë	2
3	Kontenier 1 m ³	Doganë	6
4	Kamion për koshat nëntokësorë	Doganë	1
5	Autobot uji (Ford Transit)	Doganë	1
6	Pjesë këmbimi	Doganë	
7	Set me pajisje të konsumueshme	Doganë	
8	Kosha nëntokësorë	Doganë	20
9	Kosha nëntokësorë	Jashtë territorit shqiptar	30
10	Kamionë me vinç	Ambientet e furnitorit në Tiranë	2
11	Kamion vetëshkarkues	Ambientet e furnitorit në Tiranë	1
12	Mjet ngritës pirun	Ambientet e furnitorit në Tiranë	1

Vendimet e Gjykatave, Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar dhe fondi i financuar nga Ministria e Financave, i kanë krijuar Bashkisë Vlorë mundësinë e pagesës së detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera financiare, për makineritë dhe pajisjet e destinuar për Impiantin e trajtimit të mbetjeve në Sherishtë.

Në vazhdim ju paraqesim një pëmbledhje të gjithë detyrimeve të prapambetura dhe të palikujduara nga shoqëria Integrated Technology Services, ndaj furnitorëve të kontraktuar nga ana e saj, për furnizimin me makineri dhe pajisje të Bashkisë Vlorë, si dhe ndaj subjekteve të tjera shtetërore dhe private, në të cilat përfshihen detyrime të prapambetura , detyrime doganore , detyrime parkimi etj.

1.	Autobot karburanti 8.000 litër	1	copë
2.	Konteinerë 35 m3	5	copë
3.	Konteinerë 20 m3	2	copë
4.	Konteinerë 1 m3	6	copë
5.	Kosha nëntokësorë	50	copë
6.	Kamion për koshat nëntokësorë	1	copë

Për furnizimet e mësipërme detyrimi doganor është 11.400.000 lekë (tabela bashkëlidhur dërguar me email)

Ndaj subjektit ELKOPLAST POLAND SPÓLKA Z O.O. egziston një detyrim prej 5.000.000 lekë për pagesën e transportit të 20 koshave nëntokësorë , të tarifës së parkimit të mjeteve të transportit në doganë dhe për pagesën e drejtuesve të mjeteve, për një periudhë 3 mujore (deri 31.03.2023), për shkak të bllokimit të tyre në doganën e Tiranës (sipas faturës bashkëlidhur)

Ndaj agjensisë doganore Continental Group sha ekziston një detyrim prej 15.000.000 lekë si detyrim për parkimin e mjeteve dhe magazinimin e pajisjeve të sipërpërmendura (llogaritur deri 31.12.2024).

Përveç detyrimeve të mësipërme , është parashikuar një fond rezervë prej 5.600.000 lekë për detyrime të tjera , të pa parashikuara më sipër.

Likuidimi i këtyre detyrimeve, do të mundësonte zgjidhjen përfundimtare të një situatë të komplikuar të krijuar pas ndërprerjes nga ana e Bashkisë Vlorë të kontratës me shoqërinë Integrated Technology Service, e cila jo vetëm pengon vënien në punë të Landfillit të Sherishtës dhe fillimin e depozitimit të mbetjeve në të , por që me zgjatjen në kohë vazhdon të gjenerojë detyrime të reja financiare.

Projektvendimi *“Për pagesën e detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera financiare, për makineritë dhe pajisjet e destinuara për Bashkinë Vlorë nga fondi i pakushtëzuar vënë në dispozicion për këtë qëllim nga Ministria e Financave ”* zgjidh në mënyrë përfundimtare problemin e dorëzimit në Bashkinë Vlorë të makinerive dhe pajisjeve të destinuara për Qendrën Rajonale të Trajtimit dhe Depozitimit të Mbetjeve Urbane në Sherishtë - Vlorë

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë , miratimin e kryerjes së pagesave sipas zërave dhe vlerave të paraqitura në këtë Projektvendim.

Ju faleminderit !

DREJTOR

ARJONA BOJAXHIU

